



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Kom.Dh.shk.II.nr.112/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.P.T “Labinoti” me NUI 810345125 dhe seli ne Mitrovicë, rr. “Gjon Serreqi” nr.187, kundër debitorit “TREPCA” sh.a., me seli në Mitrovicë, me bazë juridike përmbarimore, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhoma e Shkalles se Parë, KPPP.nr.2442/22, të datës 31.10.2023, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “TREPCA” sh.a., me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhoma e Shkalles se Parë, KPPP.nr.2442/22, të datës 31.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2442/22, të datës 26.12.2023, në dispozitivin e aktvendimit te atakuar, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit “TREPCA” sh.a., me seli në Mitrovicë, i paraqitur kundër urdhrorit Përmbarimore i Përmbaruesit Privat P.nr.165/2022 i datës 24.10.2022.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori “TREPCA” sh.a., me seli në Mitrovicë, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa dhe të anulohet në tërësi aktvendimi KPPP.nr.2442/22, i datës 26.12.2023 i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhoma e Shkalles se Parë

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar pala kreditore.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.P.T “Labinoti” me NUI 810345125 dhe seli ne Mitrovicë, me datën 24.10.2022 ka paraqitur propozim për përmbarrim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës 009/2021 e dt.10.03.2021, faturës 012/2021 e dt.10.04.2021, faturës 016/2021 e dt.10.06.2021, faturës 048/2021 e dt.09.12.2021 per borxhin e mbetur në shumën e përgjithshme prej 23,264.72€ si dhe ka kërkuar ti paguaj shpenzimet e procedurës përmbarrimore si dhe taksat dhe shpenzimet e tjera të përmbarruesit.

Përmbarruesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin përmbarrimor P.nr.165/2022 të dt. 24.10.2022, e ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitorin me datë 27.10.2022, ka ushtruar prapësim duke propozuar që të pranohet prapësimi i “TREPÇA” sh.a., me seli në Mitrovicë dhe të anulohet urdhri për përmbarrim.

Kreditori nuk ka paraqitur pergjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkalles se Parë duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2442/22, të datës 31.10.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarrimit P.nr.165/2022 të dt. 24.10.2022, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin të aktvendimit te atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi duhet të refuzohet si të pabazuar, dhe ka vendosur si në dispozitiv, pasi që ka gjetur se i njëjti nuk përmbush asnjë nga kushtet ligjor e parapara me nenin 71 sikurse kërkohet me dispozitat e LPP-së, ngase në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës e cekura në propozim për përmbarrim të ushtruar nga kreditorit është dokument i besueshem-titull ekzekutiv konform nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Duke qenë se në rastin konkret nuk ekziston asnjëri nga shkaqet që parashihet në nenin 71 të LPP –së, Gjykata e shkallës së parë gjeti se dokumentet qe ka shërbyer si dokumenti përmbarrimor, janë dokumente të besueshme-titull ekzekutiv komfor nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Gjykata e Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se Gjykata Themelore në Mitrovicë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e tillë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar edhe gjendja

faktike, shkelje të cilat Gjykata Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim në baze të fatures 009/2021 e dt.10.03.2021, faturës 012/2021 e dt.10.04.2021, faturës 016/2021 e dt.10.06.2021, faturës 048/2021 e dt.09.12.2021 për borxhin e mbetur në shumën e përgjithshme prej 23,264.72€, ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë ku në piken 1.3. përcaktohet se janë edhe “*faturat*”, kurse në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin faturën e cila paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është e pranuar si dokument - titull ekzekutiv për përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 29 të LPP-së.

Gjithashtu, pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se gjykata e shkallës së parë ka bërë konstatim të gabuar dhe je të plotë të gjendjes faktike edhe se të drejtën materiale gabimisht e ka aplikuar, mirëpo këto pretendime Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë. Kjo për faktin se Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, me të drejtë ka vlerësuar kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur ndaj propozimit të përmbarimit, sepse pretendimet në prapësim ishin të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresa të lëndës, dhe më këtë rast debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se i njëjtit ka paraqitur ndonjë ankese ndaj kreditorit për faturën e lëshuar nga kreditorit. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimorë të palës debitorë, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pa bazuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.112/24, me datë 04.06.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami